



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

DRAFT

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E TARIFAVE TË PËRDORIMIT TE RRJETIT TË TRANSMETIMIT DHE SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR

Pjesa I – Termat e përgjithshëm

1. Autoriteti

Kjo metodologji e llogaritjes së tarifave të rrjetit të gazit është hartuar në mbështetje të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”

2. Qëllimi dhe fusha e aktivitetit

Qëllimi i kësaj metodologjie është vendosja e rregullave për llogaritjen e tarifave të aksesit dhe përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit në Shqipëri si dhe tarifave të shërbimeve të ofruara nga operatori i rrjetit të gazit, si ç’parashikohet në nenin 32, pika 1 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” (tarifat e rrjetit). Tarifat e rrjetit do të vendosen nga operatori i rrjetit të gazit në përputhje me këtë metodologji. Kjo metodologji nuk trajton tarifën e aksesit dhe përdorimit të TAP (Trans Adriatic Pipeline).

3. Termat e përdorur në këtë metodologji

Termat e përgjithshëm të përdorur në këtë metodologji janë marrë nga Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Ato kanë kuptimet e mëposhtme:

- 3.1 “Periudha rregullatore” e llogaritjes do të thotë periudha e aktivitetit të operatorit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror e cila zgjat 12 muaj dhe përkon me vitin kalendarik.
- 3.2 “Rrjet” do të thotë tërësia e rrjeteve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri.
- 3.3 “Operator rrjeti” do të thotë subjekti apo subjektet që operojnë rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror në Shqipëri.

Te gjitha termat e përdorura në këtë Metodologji kanë të njëjtin kuptim me përcaktimet e Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

4 Parimet bazë të vendosjes së tarifave

4.1 Shmangia nga çdo parashikim i kësaj metodologjie do të çojë në refuzimin nga ERE të aplikimit për tarifa të operatorit të rrjetit.

4.2 Tarifat e rrjetit do të llogariten në bazë të kostove të rrjetit të cilat do të konstatohen dhe trajtohen në përputhje me nenet 6 – 10 të kësaj metodologjie. Kostot dhe tarifat e rrjetit do të llogariten në bazë të të dhënave të përfituara nga viti i mëparshëm i aktivitetit të operatorit të rrjetit, por mund të merret parasysh edhe informacioni i përftuar në vitin aktual, në rast se vlerësohet i besueshëm.

Kostot e rrjetit do të llogariten si më poshtë:

$$GC = C + D + ROC - CRI + OCP$$

Ku:

GC	Kostot vjetore të rrjetit
C	Elementët e kostos si ç'përcaktohet në nenin 7
D	Amortizimi si ç'përcaktohet në nenin 8
ROC	Kthimi mbi kapitalin si ç'përcaktohet në nenin 9
CRI	Të ardhurat e zbritshme si ç'përcaktohet në nenin 10
OCP	Axhustimet e periudhave të ndryshme si ç'përcaktohet në nenin 11

4.3 Vendosja e tarifave të rrjetit do të bazohet në këto parime:

1. Tarifat e rrjetit do të pasqyrojnë kostot
2. Tarifat e rrjetit do të llogariten në mënyrë të tillë që, në fund të periudhës rregullatore, diferenca ndërmjet kostove reale të rrjetit (të ardhurave të realizuara) dhe atyre të lejuara nëpërmjet tarifës të jetë sa më e vogël.
3. Nuk lejohen subvencionime ndërmjet klasave të ndryshme të klientëve.
4. Tarifat e rrjetit duhet të pasqyrojnë kostot aktuale të shërbimit për çdo klient dhe duhet të alokohen në mënyrë sa më të drejtë.
5. Tarifat e rrjetit duhet të japin sinjalet e duhura për përdorimin me efikasitet të rrjetit.
6. Shpenzimet e lejuara në tarifë duhet të jenë transparente për të gjithë pjesëmarrësit.
7. Tarifat e rrjetit duhet t'i lejojnë operatorit të rrjetit të përfitojë normën e lejuar të kthimit mbi bazën e rregulluar të asetëve të miratuar nga ERE.
8. Tarifat e rrjetit duhet të mbeten të qëndrueshme në kohë.

5 Periudha rregullatore e llogaritjes dhe tabelat bazë

- 5.1. Periudha rregullatore e llogaritjes duhet të jetë e njëjtë si për rrjetet e transmetimit ashtu edhe ato të shpërndarjes
- 5.2. ERE do të mundësojë tabela standarte për efekt të llogaritjes së tarifave. Operatori i rrjetit do t'i përdorë këto tabela të vëna në dispozicion nga ERE kur të aplikojë për tarifë për një periudhë të caktuar. Format i tabelave mund të modifikohet nëse informacioni organizohet (paraqitet) në mënyrë të ngjashme dhe detajimi i tij nuk është më i vogël se ai i tabelave standarte të miratuara.

Pjesa II – Llogaritja e tarifave të rrjetit

6 Parimet e llogaritjes së kostove të rrjetit

Kostot e vërejtura dhe të shfaqura në pasqyrat financiare të operatorit të rrjetit do të merrren parasysh deri në masën që ato përkojnë me kostot që do të kishte një operator rrjeti eficient dhe i mirëmenaxhuar dhe që do të shmangte shpenzimet e tepërta. Rregullatori ka të drejtën të shqyrtojë nivelin e kostove të raportuara nga operatori i rrjetit dhe t'i krahasojë ato me kostot për njësi të operatorëve të tjerë rajonalë apo të rezultuara nga “benchmark” -u.

- 6.1 Kostot e rrjetit do të përcaktohen pasi të bëhen analizat përkatëse, bazuar në llogarinë humbje/fitime të aktivitetit të vitit paraardhës, pas mbylljes së tij. Si ç'po përmendim në këtë paragraph, kostot e rrjetit do të jenë ato aktuale, sipas nenit 7, ato të amortizimit sipas nenit 8, ato të kthimit mbi kapitalin sipas nenit 9 dhe të ardhurave të zbritshme nga ato të lejuara sipas nenit 10.
- 6.2 Operatori i rrjetit do të marrë në konsideratë vetëm ato kosto apo komponentë të tyre që kanë të bëjnë me marrjen nga të tretët të aseteve fikse të nevojshme për kryerjen e aktivitetit njësoj sikur t'i zotëronte vetë ato. Operatori i rrjetit duhet që për secilën nga këto kosto të paraqesë dokumenta dhe prova.
- 6.3 Në rast se një Shoqëri e caktuar ofron shërbime ndaj operatorit të rrjetit, kostoja e këtyre shërbimeve apo elementë të saj do të trajtohen sipas parashikimeve të këtij paragrafi. Nëse Shoqëria që ofron shërbimet dhe operatori i rrjetit apo ndonjëri nga aksionarët e operatorit të rrjetit i përkasin të njëjtit grup Shoqërish, operatori i rrjetit do të përballojë vetëm kostot reale apo komponentët e tyre, sipas primeve të përmendura në këtë metodologji. Nëse Shoqëria që ofron shërbimet dhe operatori i rrjetit apo ndonjëri nga aksionerët e operatorit të rrjetit nuk i përkasin të njëjtit grup Shoqërish, operatori i rrjetit do të përballojë vetëm ato kosto apo komponentë të tyre, sikur ta kishte kryer vetë punimin. Operatori i rrjetit duhet të paraqesë dokumentat dhe provat e nevojshme për këto shpenzime.
- 6.4 Nëse ndodhin zëra të jashtëzakonshëm të shpenzimeve/të ardhurave, ato duhet t'i raportohen pa vonesë rregullatorit.

7 Kostot aktuale

Zërat e kostove të pasqyruara tek PASH (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) si për Shoqëritë e transmetimit, ashtu edhe ato të shpërndarjes së gazit natyror do të merren parasysh në përcaktimin e kostove të rrjetit. Me kosto aktuale kuptojmë kostot direkte të operimit (kostot e personelit dhe ato materiale), kostot indirekte të operimit (mirëmbajtje, shërbime dhe riparime) si dhe shpenzime të përgjithshme (qira, siguracione dhe kosto energjie). Amortizimi dhe interesi mbi borxhet nuk do të pasqyrohet tek kostot aktuale, pasi ato do të pasqyrohen në kostot të tjera të aktivitetit sipas neneve 8 dhe 9.

8 Amortizimi i lejuar

- 8.1 Për të mundësuar një operim afatgjatë, të besueshëm dhe të sigurt të rrjetit, do të llogarisim rënien në vlerë të aseteve të nevojshme për operimin e rrjetit, si rezultat i vjetërimit (amortizimit) të tyre, siç përshkruhet në nenet 2 dhe 4. Prandaj në llogaritjen e kostove do të përfshijmë edhe kostot e amortizimit të cilat raportohen në PASH (pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve).
- 8.2 Amortizimi i aseteve do të llogaritet bazuar në koston e tyre historike sipas metodës së amortizimit linear.
- 8.3 Amortizimi i secilit aset do të llogaritet çdo vit bazuar në jetëgjatësinë e tij. Jetëgjatësia e çdo asemi nuk do të ndryshojë për periudhat e mbetura të llogaritjes së amortizimit. Llogaritja e amortizimit do të bëhet çdo vit. Çdo aset njihet në shtesë të aseteve fikse që nga data 1 Janar e vitit që ky aset është përfutur. Jetëgjatësitë përkatëse janë të përcaktuara në aneksin 1.
- 8.4 Pas përfundimit të periudhës së amortizimit të një asemi vlera e tij do të konsiderohet zero. Nuk lejohet rivlerësim i këtij asemi.

9 Kthimi i lejuar mbi kapitalin

- 9.1 Kthimi mbi kapitalin i operatorit të rrjetit do të ndikohet nga vlera e kthimit mbi shumën e kapitalit që i duhet operatorit të rrjetit (Baza e Rregulluar e Aseteve – RAB). Baza e Rregulluar e Aseteve (RAB) i nevojshëm për operimin e rrjetit do të llogaritet si më poshtë:

$$RAB = RV + CA + L + AUC - P - AP - TP - OL$$

Ku

RV vlera e mbetur e aseteve fikse të trupëzuara të nevojshme për operimin e rrjetit të llogaritura me koston historike të blerjes apo prodhimit në fillim të periudhës rregullatore (*pas zbritjes së shumës së amortizimit të aseteve*).

CA vlera sipas bilancit e aseteve qarkulluese të nevojshme për operimin e rrjetit (Kapitali i Punës)

L vlera e tokës sipas çmimit të blerjes

AUC parapagimet dhe asetet në ndërtim (investimet në proçes)

P provigjonet

AP Pagesat e marra në avancë si dhe parapagimet (paradhëniet) nga klientët

TP llogari të pagueshme mbi të cilat nuk paguhet interes

CG	Vlera e asetëve të përfituara nëpërmjet dhurimit
OL	të tjera të pagueshme deri në masën e fondeve në dispozicion të operatorit të rrjetit dhe që mbi të cilat nuk llogaritet interes

Në çdo rast do të merret parasysh mesatarja e vlerës në fillim dhe në fund të vitit.

Në kuptim të paragrafit të sipërpërmendur, provigjonet janë detyrime të papërcaktuara në vlerë dhe kohë. Zakonisht vlerësohen me vlerën e arësyeshme që një subjekt paguan në mënyrë që të mbyllë një detyrim në fund të periudhës raportuese apo t'ja transferojë atë një pale të tretë. Në vlerësimin e një provigjoni merren parasysh risqet dhe pasiguritë.

Në kuptim të paragrafit të sipërpërmendur, aktivet qarkulluese do të llogariten deri në një shumë të nevojshme për operimin e rrjetit. Operatori i rrjetit duhet të paraqesë në ERE një studim për fondet e kërkuara për mbajtjen e një niveli të përshtatshëm të lëndëve të para, materialeve apo mjeteve monetare për përballimin e detyrimeve korrente apo mbajtjen e rezervave minimale. Në rast se një studim i tillë nuk është i mundur, operatori i rrjetit mund të paraqesë një vlerësim të përafërt të aktiveve korrente me një arsyetim me shkrim për këtë vlerësim të përafërt. Në çdo rast, aktivet qarkulluese nuk duhet të tejkalojnë vlerën e 1/12 të shpenzimeve operative (OPEX) për një periudhë të dhënë rregullatore.

9.2 Operatori i rrjetit duhet të paraqesë dokumentat dhe faktet e nevojshme për këtë qëllim.

9.3 Kthimi mbi kapitalin do të llogaritet në bazë të Kostos Mesatare të Ponderuar të Kapitalit (WACC). Baza e rregulluar e asetëve (RAB) do të shumëzohet me WACC. Llogaritja do të bazohet mbi një strukturë kapitali prej 60% borxh dhe 40% kapitale të vetat. Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit llogaritet si më poshtë:

$$WACC = [ES * ARoE / (1 - T)] + (DS * CoD)$$

$$ES + DS = 1$$

Ku:

ES norma që synohet për raportin e kapitalit e vet Shoqërisë në RAB (40%)

T norma e taksës së Korporatës

ARoE kthimi i lejuar mbi kapitalin e vet (pas taksave)

DS norma që synohet për raportin e borxhit në RAB (60%)

CoD kostoja e borxhit

9.4 Kthimi i lejuar mbi kapitalin pas taksave merret norma bazë e interesit si dhe një premium për riskun specifik të operatorit të rrjetit. Norma bazë e interesit merret vlera mesatare 5 vjeçare e mesatares së ponderuar të obligacioneve qeveritare të publikuara nga Banka e Shqipërisë.

- 9.5 Për të llogaritur riskun specifik të operatorit të rrjetit, në mënyrë të veçantë duhet të merren parasysh faktet e mëposhtme:
1. Gjendja e tregjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të gazit natyror si dhe vlera e operatorëve të rrjeteve të gazit natyro në këto tregje.
 2. Kthimi mesatar mbi kapitalin i operatorëve të rrjeteve të gazit në tregjet e huaja.
 3. Risku aktual dhe i matshëm i biznesit.
- 9.6 Kthimi mbi kapitalin pas taksave do të vendoset nga ERE. Herën e parë, ky vendim duhet të merret dhe të publikohet në fillim të vitit në të cilin operatorët e rrjetit fillojnë aktivitetin dhe në vazhdim, çdo tre vjet.
- 9.7 Norma mesatare e interesit mbi huanë e përdorur për llogaritjen e WACC do të merret mesatarja 5 vjeçare e normave mesatare vjetore të interesit të huave të reja në lekë për prona të patundshme të Korporatave private jofinanciare.

10 Të ardhura të tjera të zbritshme

Ta ardhura të tjera mund t'u zbriten kostove të rrjetit me kusht që këto të ardhura duhet të burojnë nga shfrytëzimi i rrjetit dhe në mënyrë të veçantë t'i referohen këtyre elementëve të fitimit të lidhura me shfrytëzimin e rrjetit.

1. Puna e vetkapitalizuar (own work)
2. Të ardhurat nga interesi dhe investimet
3. Kostot e lidhjes në rrjet
4. Të ardhura të tjera

11 Axhustimi i periudhave të mëparshme rregullatore

Pas mbylljes së periudhës rregullatore, operatori i rrjetit duhet të llogarisë diferencën ndërmjet:

1. Të ardhurave të fituara nga tarifat e rrjetit gjatë periudhës në fjalë
2. Të ardhurave të lejuara për të njëjtën periudhë

Nëse të ardhurat e llogaritura sipas pikës 1 të këtij neni tejkalojnë ato të lejuara sipas pikës 2, kjo diferencë, si dhe një shumë interesi me një normë të caktuar duhet t'u zbritet të ardhurave të realizuara sipas tarifave të përcaktuara (duhet të reduktojë kostot). Nëse të ardhurat e llogaritura sipas pikës 1 të këtij neni nuk arrijnë të ato të lejuara sipas pikës 2, kjo diferencë, do të shkojë në rritje të kostove. Ky axhustim do të bëhet brenda tre viteve pasardhës.

12 Llogaritja e kostove dhe zhvillimi i tyre

- 12.1 Kostot totale të rrjetit do t'i alokohen rrjetit të transmetimit, të shpërndarjes si dhe sistemit të matjes në mënyrë të përshtatshme dhe të kuptueshme.
- 12.2 Kostot e rrjetit të transmetimit janë kostot e shkaktuara rrjetit të transmetimit si dhe kosto të tjera të përgjithshme që do t'i alokohen në mënyrë të përshtatshme rrjetit të transmetimit.
- 12.3 Kostot e rrjetit të shpërndarjes janë kostot e shkaktuara rrjetit të shpërndarjes si dhe kostot të tjera të përgjithshme që do t'i alokohen në mënyrë të përshtatshme rrjetit të shpërndarjes.
- 12.4 Kostot e sistemit të matjes janë kostot e shkaktuara sistemit të matjes si dhe kosto të tjera të përgjithshme që do t'i alokohen në mënyrë të përshtatshme sistemit të matjes.
- 12.5 Konsumatorët fundorë si dhe klientët e lidhur në rrjetin e transmetimit, për qëllim llogaritjeje të kostove, trajtohen njësoj si përdorues të rrjetit të transmetimit. Përcaktimi i shumës së kostove të rrjetit të transmetimit që duhet të përballohen nga rrjeti shpërndarjes duhet të bazohet në vlerën maksimale vjetore të ngarkesës si dhe tarifën përkatëse të kapacitetit të klientëve.
- 12.6 Alokimi i kthimit mbi kapitalin për rrjetin e transmetimit, shpërndarjes dhe sistemit të matjes kryhet mbi bazën e vlerës së mbetur të aseteve që përdoren për të përcaktuar kthimin mbi kapitalin.
- 12.7 Kostot e mbetura të rrjetit të cilat nuk mund t'i alokohen rrjetit të transmetimit, të shpërndarjes apo atij të matjes, do t'u alokohen respektivisht këtyre rrjeteve në mënyrë të përshtatshme dhe gjithpërfshirëse bazuar në një faktor alokimi.

13 Rregulla të veçanta për vendosjen e tarifës

- 13.1 Kostot e rrjetit do të llogariten mbi baza vjetore.
- 13.2 Tarifat e rrjetit nuk do të varen nga niveli i presionit apo largësia ndërmjet pikës së hyrjes dhe të daljes së gazit natyror. Tarifat e rrjetit do të llogariten në mënyrën e duhur dhe gjithpërfshirëse.
- 13.3 Tarifa e rrjetit në pikat hyrëse dhe dalëse të rrjetit të transmetimit konsiston në një tarifë kapaciteti në lekë/kW. Tarifat e kapacitetit duhet të bëhen të ditura si për kapacitetin e vazhdueshëm, ashtu edhe atë me ndërprerje. Tarifa e kapacitetit me ndërprerje do të marrë parasysh probabilitetin e ndërprerjes. Tarifat do të vendosen në mënyrë të veçantë për çdo pikë hyrjeje në sistem apo daljeje jashtë sistemit të transmetimit të gazit natyror.
- 13.4 Tarifa për pikat dalëse të rrjetit të shpërndarjes do të përbëhet nga tarifa e kapacitetit vjetor në lekë/kW dhe tarifa e energjisë në lekë/kWh. Kërkesa vjetore për të ardhura nga kapaciteti llogaritet duke shumëzuar tarifën për njësi të kapacitetit me kapacitetin maksimal në kW në pikën e daljes, për vitin e operimit. Kërkesa vjetore për të ardhurat nga energjia do të llogaritet duke shumëzuar tarifën për njësi të energjisë me konsumin e energjisë në kWh në po atë vit.
- 13.5 Për shitjet pa profil ngarkese në rrjetin e shpërndarjes do të vendoset një çmim energjie në lekë/kWh në vend të aplikimit të një tarife kapaciteti dhe energjie. Deri sa të vendoset një tarifë mujore në lekë/Muaj, ky çmim bazë dhe tarifa e energjisë do të

jenë në proporcion të arsyeshëm. Tarifa që rezulton nga çmimi bazë dhe tarifa e energjisë duhet të jenë në proporcion të arsyeshëm me tarifën që do të paguhej në rast të një shpërndarjeje mbi bazë të profilit të ngarkesës bazuar në të dhënat e kërkesës për kapacitet dhe energji në përputhje me profilin standart të ngarkesës së përdoruesve të rrjetit.

- 13.6 Operatori i rrjetit është përgjegjës për llogaritjen e tarifave të rrjetit. Tarifat e rrjetit duhet të reflektojnë kostot. Kostoja e rrjetit të transmetimit do të përballohet plotësisht nga tarifa e kapacitetit. 30% e kostove të rrjetit të shpërndarjes do të përballohen nga tarifa e energjisë ndërsa 70 % e kostove të rrjetit të shpërndarjes do të përballohen nga tarifa e kapacitetit. Tarifat e kapacitetit mund të varen nga maksimumi i kërkesës vjetore ndërsa tarifa e energjisë varet nga konsumi vjetor i energjisë.
- 13.7 Tarifat për matjen do të vendosen për të gjitha pikat hyrëse dhe dalëse. Këto tarifa mbulojnë vendosjen, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e matësave (kostot kapitale) si dhe leximin dhe përpunimin e të dhënave. Llogaritja e tarifave të matjes duhet të reflektojë kostot.
- 13.8 Tarifat e rrjetit duhet të llogariten në mënyrë të tillë që, në fund të periudhës ushtrimore, të minimizojnë diferencën ndërmjet të ardhurave të kërkuara dhe atyre të realizuara përgjatë së njëjtës periudhë.
- 13.9 ERE është autoriteti që vendos strukturën e tarifave të rrjetit dhe atyre të matjes.
- 13.10 Operatori i rrjetit do të mbajë të dhëna të detajuara të mënyrës së llogaritjes së tarifave, në mënyrë që ato të jenë të kuptueshme për të tretët, si dhe të vihen në dispozicion me t'u kërkuar nga ERE.

Pjesa III – Dispozitat Përfundimtare

14 Afatet

- 14.1 Bazuar në këtë metodologji, operatori i rrjetit do të paraqesë në ERE një kërkesë për miratimin e tarifave të reja, jo më vonë se 6 muaj para hyrjes së tyre në fuqi.
- 14.2 Në aplikim, operatori i rrjetit do të paraqesë në ERE të gjithë të dhënat e nevojshme për kostot e rrjetit të vitit paraardhës.
- 14.3 Pasi të marrë vendimin, ERE do t'ja njoftojë atë operatorit të rrjetit deri në fund të Nëntorit të atij viti. Operatori i rrjetit i publikon këto tarifa tre ditë pas është njoftuar.

15 Kërkesat për Publikim

- 15.1 Operatori i rrjetit është i detyruar të publikojë tarifat e rrjetit në faqen e tij të internetit si dhe të japë informacion me shkrim sipas kërkesës.
- 15.2 Për më tepër, operatori i rrjetit, në datë 1 Prill të çdo viti duhet të publikojë këto karakteristika të rrjetit :
 1. Gjatësia e gazsjellësit ndarë sipas niveleve të presionit (i ulët, i mesëm, i lartë) në 31 Dhjetor të vitit parardhës.

2. Gjatësia e gazsjellësit në nivel të lartë presioni ndarë sipas llojeve të diametrit të tubacionit.
3. Energjia vjetore (në kWh apo m³) lëvruar shpërndarësve dhe klientëve fundorë në vitin paraardhës.
4. Numri i pikave dalëse për çdo nivel presioni
5. Maksimumi i kërkesës vjetore për të gjitha pikat e lëvrimit në MW apo m³ për orë si dhe koha në të cilën ndodh.

16 Dokumentacioni

16.1 Me vendosjen e tarifave, operatori i rrjetit do të përgatisë një raport në lidhje me këto tarifa. Raporti duhet të përmbajë:

1. Një përshkrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet për të gjithë periudhën;
2. Një pasqyrim të plotë të metodës së llogaritjes së tarifave të rrjetit si dhe shpjegime të tjera plotësuese në lidhje me këto tarifa
3. Metoda e alokimit e përdorur në zbatim të nenit 11
4. Raporti i plotë i auditimit të pasqyrave financiare si dhe dokumenta të tjera plotësuese.

16.2 Ky raport do të ruhet për një periudhë 10 vjeçare.

17 Monitorimi, vlerësimi dhe të drejtat e ERE-s.

17.1 ERE vazhdimisht monitoron aplikimin e tarifave nga operatori i rrjetit. 5 vjet nga hyrja në fuqi e kësaj metodologjie, ERE vlerëson përshtatshmërinë dhe funksionimin e metodologjisë dhe publikon një raport në lidhje me statusin e mëtejshëm të kësaj metodologjie. Raporti përmban informacionin e nevojshëm në lidhje me investimet e operatorit të rrjetit, efektshmërinë si dhe masat e marra për shmangjen e barrierave në lidhje me investimet.

17.2 Në këtë raport ERE mund të propozojë në lidhje me, ndër të tjera:

1. Heqjen e barrierave për investimet;
2. Zhvillimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë së tarifave;
3. Zhvillimin e rregullave të mëtejshme në lidhje me transparencën e metodologjisë së tarifave;
4. Hartimin e një metodologjie të re tarifash (p.sh: nëpërmjet mekanizmave nxitës)
5. Hartimin e metodologjive të veçanta për aktivitetet e operimit të rrjeteve të transmetimit dhe të shpërndarjes;

18 Dispozita tranzitore

- 18.1 Nëse ndodh që tarifat e llogaritura në bazë të kësaj metodologjie tejkalojnë mesataren e tarifave të rrjetit në vendet fqinje dhe si rrjedhojë çmimet e gazit të klientëve fundorë nuk janë konkurrues krahasuar me burimet alternative të energjisë, llogaritja e tarifave të rrjetit, sipas nenit 13 mund të bëhet në bazë të analizave krahasuese të operatorëve të rrjetit në vendet fqinje. Operatori i rrjetit mund ta shfrytëzojë këtë opsion vetëm për 5 vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie. Operatori i rrjetit do të paraqesë një vëzhgim mbi tarifat e rrjetit në vendet fqinje si dhe një vlerësim në lidhje me kokurrueshmërinë e çmimeve të klientëve fundorë që furnizohen me gaz natyror në Shqipëri, me të dhëna të sakta që mbështesin një vlerësim të tillë. Këto materiale duhet të përgatiten çdo vit dhe do t'i bashkohen dosjes së aplikimit për tarifë, sipas nenit 14.1. ERE, në mënyrë të veçantë do të miratojë një përjashtim të tillë sipas nenit 14.3.
- 18.2 Nëse ndodh që mungojnë të dhënat nga vitet paraardhëse sipas nenit 4.2, për periudhën e parë rregullatore pas hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, operatori do të paraqesë një vlerësim me të dhëna të arsyeshme, gjatë aplikimit për tarifë.
- 18.3 Çdo amendim i Ligjit 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” në lidhje me vendosjen e tarifave të rrjeteve të gazit apo mbulimit të kostove të rrjetit nuk do të ndikohet nga parashikimet e kësaj metodologjie.

19 Dispozita përfundimtare

Metodologjia për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, u miratua me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. __, datë ____.

Aneksi 1

	Limiti I poshtëm	Limiti I sipërm
	Vitet	Vitet
Parcela Toke	∞	∞
Prona, Ndërtesa për Transport	25	35
Ndërtesa për Shoqërinë	50	60
Ndërtesa për Zyra	60	70
Hekurudha dhe vagona	23	27
Paisje Zyre (pa programet dhe paisjet shtesë)	8	10
Mjetet e punës/ paisjet	14	18
Magazinat	14	25
Paisjet kompjuterike	4	8
Programet kompjuterike	3	5
Makineritë e lehta	5	5
Makineritë e rënda	8	8
Depozitat e gazit	45	55
Ambientet e komprimimit të gazit		
Komprimimi i gazit	25	25
Ambientet e pastrimit të gazit	25	25
Tubacionet dhe montimi	25	25
Matja e gazit/ ambientet e matjes	25	25
Infrastruktura për sigurinë (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Teknologjia e kontrollit të energjisë (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Ambientet ndihmëse (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Ndërtesat, infrastruktura e transportit (ambientet e komprimimit të gazit natyror)	25	25
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (tuba çeliku – veshja me polietilen)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (tuba çeliku – mbrojtja katodike)	55	65
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (tuba çeliku – izoluar me katrama)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (giza gri; Diametri Nominal > 150)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (forma të derdhura në fonderi)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (polietilen molekular me dendësi të lartë)	45	55
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (PVC)	30	40
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (montime/ stacione montimi)	45	45
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (sondat pastruese të	45	45

tubacioneve)		
Tubacionet/ tubat shtëpiakë (paisjet e sigurisë)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (matësit e sasisë së gazit)	8	16
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (rregullatori i trysnisë së gazit)	15	25
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (paisjet matëse)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (paisjet kontrolluese)	45	45
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (vendosja e paisjeve të sigurisë)	20	30
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (teknologjia e kontrollit të energjisë)	10	30
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (kompresorët në sistemin e përzierjes së gazit në varësi të afatit të përdorimit)	15	30
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (sistemet ndihmëse)	15	30
Matja, sistemi i matjes dhe kontrollit (ndërtesat)	60	60
Sistemet e kontrollit në distancë	15	20